



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT  
I  
AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 453/2018

*Mungesa e kushteve të përshtatshme për banim të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të  
kthyer nga Maqedonia e Veriut në Obiliq*

**Drejtuar:**

Z. Nenad Rasić, ministër  
Ministria për Komunitete dhe Kthim

Z. Xhafer Gashi, kryetar  
Komuna e Obiliqit

**Kopje:**

Z. Elbert Krasniqi, ministër  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Z. Habit Hajredini, drejtor  
Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës

Prishtinë, 10 nëntor 2023

## QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e qeverisjes lokale dhe asaj qendrore për nevojën e ndërmarrjes së veprimeve me qëllim të krijimit të kushteve të dinjitetshme dhe të përshtatshme të jetesës për banorët e fshatit Plemetin, kryesisht familje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të zhvendosura nga lufta e fundit, dhe të kthyer në Kosovë vite më parë nga Maqedonia e Veriut.

Procesi i kthimit të personave të zhvendosur ka dimension kompleks në vetvete edhe trajtimi i kësaj çështjeje, po ashtu mund të jetë kompleks për vet faktin se problemet janë shtresuar me vite, mund të ketë diskutime për procesin dhe mënyrën e kthimit, koncentrimin e të kthyerve në një hapësirë të caktuar, mungesën e pronës, të kthyerit që asnjëherë më parë nuk kanë qenë banorë të atij lokaliteti, reagimin dhe mënyrën e pranimit të të kthyerve nga komuniteti pritës, mungesën e regjistrimit në regjistrat e gjendjes civile etj. Mirëpo, sado që mund të jetë kompleks trajtimi i kësaj çështjeje, nuk duhet të merret shkas që të mos ndërmerren veprime konkrete nga autoritete lokale dhe qendrore për ndryshimin e kësaj gjendjeje, e vlerësuar aspak e dinjitetshme e këtyre banorëve.

Ky raport, nëpërmjet një analize të gjendjes aktuale, veprimeve të deritanishme të autoriteteve dhe analizës ligjore, synon të adresoi nevojën e ndërmarrjes së veprimeve në drejtim të ndryshimit të kësaj gjendjeje jo vetëm nëpërmjet realizimit të programeve të veçanta të banimit por edhe adresimit të çështjeve tjera.

## KOMPETENCA E AVOKATIT TË POPULLIT

1. Neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: *Kushtetuta*) përcakton: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”
2. Gjithashtu, sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mes tjerash, Avokati i Popullit ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - “*Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.*” (Neni 16, paragrafi 4).
  - “*Tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.*” (Neni 18, nënparagrafi 1.2).
  - “*Të rekomandoj Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.*” (Neni 18, nënparagrafi 1.5).
  - “*T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.*” (Neni 18, nënparagrafi 1.6).



- “Të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryej hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.” (Pika 8).

## RRETHANAT E RASTIT

3. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka hapur rast sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) kundër Komunës së Obiliqit, përkitazi me krijimin e kushteve të përshtatshme për banim në rastin e kthimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nga Maqedonia e Veriut në Obiliq. Sipas informatave të cilat i ka në dispozicion Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), rreth 38 familje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian janë kthyer nga Maqedonia e Veriut në Komunën e Obiliqit, ku shumica prej tyre para largimit nga Kosova kanë banuar në komunat e tjera të Kosovës dhe nuk kanë prona të tyre në vendet prej nga vijnë<sup>1</sup>.
4. Më 17 gusht 2018, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit u takua me përfaqësuesin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Obiliqit, nga i cili ishte informuar se kjo komunë kishte hasur në probleme rreth pamundësisë së ofrimit të shërbimeve ndaj personave që nuk i takojnë komunës së Obiliqit, sikurse janë pajisja me dokumentacionin personal, dokumentacionin rreth pronësisë, etj.
5. Në të njëjtën datë, Avokati i Popullit ishte takuar edhe me disa nga banorët e komunitetit rom në fshatin Plemetin, nga të cilët ishte informuar se aty ishin disa familje të kthyer nga vendet e treta dhe nuk kishin prona të vetat në Kosovë dhe Komuna deri më tani nuk u kishte ofruar ndonjë zgjidhje për strehim, edhe pse ekziston një listë e familjeve të kthyer, për të cilat ka informacione që është në dijeni komuna në fjalë.
6. Më 5 qershor 2019, Avokati i Popullit, përmes shkresës zyrtare, i ishte drejtuar kryetarit të komunës së Obiliqit, nga i cili kishte kërkuar informata përkitazi me veprimet e ndërmarra apo që priteshin të ndërmerreshin nga kjo komunë për këtë çështje.
7. Më 25 qershor 2019, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga kryetari i komunës me të cilën u njoftua se prioritet për kthim kanë banorët e kësaj komune. Kryetari i komunës njofton se ka marrë edhe një kërkesë nga pjesëtarë e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të kësaj komune, me ç’ rast kanë thënë se, nëse ka raste të kthimit nga shtetet e rajonit të qytetarëve të këtyre komuniteteve, të cilët më parë i kishin takuar komunave të tjera, do ta kundërshtonin kthimin e tyre edhe përmes protestave. Më tutje thekson se, sipas Ligjit nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim të Pronave, Komuna e Obiliqit e ka të pamundur të japë apo të iniciojë procedura për dhënie në shfrytëzim të pronës për çështje private dhe se ky ligj e mundëson një gjë të tillë vetëm për shfrytëzim afarist/biznesor si dhe për zhvillim ekonomik dhe në asnjë mënyrë për ndonjë qëllim tjetër.
8. Më 21 gusht 2019, Avokati i Popullit është takuar me drejtorin e Departamentit për Menaxhim dhe Monitorim të Projekteve në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim (MKK), nga i cili është informuar se 46 familje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në Plemetin, janë përfutuese të pagesës së qirasë për gjashtë muaj, me mundësi

<sup>1</sup> Raporti mbi të drejtat e personave të kthyer rom, ashkali dhe egjiptian në Komunën e Obiliqit, të hartuar nga OJQ “Advancing Together”, të vitit 2018.



vazhdimi nga MKK-ja. Sipas tij, në këtë proces MKK-ja nuk ka ndonjë kompetencë tjetër ligjore.

9. Më 26 gusht 2019, Avokati i Popullit ka kërkuar informata nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) lidhur me procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronave të komunës për rastet e rënda sociale, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
10. Më 10 shtator 2019, MAPL ka dërguar përgjigje, përmes së cilës ka informuar se kjo ministri, me Opinionin Ligjor nr.463-1442, të datës 21 tetor 2016, ka njoftuar komunitetet lidhur me procedurat e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim për rastet e veçanta dhe për ato sociale. Sipas kësaj shkrese, sigurimi i banimit social i takon komunës, bazuar në nenin 17, pika k, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, sipas të cilit komunitetet, mes tjerash, kanë kompetencë në ofrimin e “strehimit familjar”. Gjithashtu komunitetet mund ta ofrojnë pronën e saj për qëllime të banimit social edhe në bazë të neneve 20, paragrafi 1.4, dhe 25, paragrafi 1.3, të Ligjit nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.
11. Më 30 qershor 2021, Avokati i Popullit mori pjesë në takim me banorët e fshatit Plemetin, i cili ishte i organizuar nga kryetarin të komunës së Obiliqit. Ky takim ishte si pjesë e vazhdimësisë nga takimi i Avokatit të Popullit me kryetarin e Komunës Obiliqit, të mbajtur me 16 korrik 2021, ku u shtrua nevoja për një takim me banorët e fshatit Plemetin, lidhur me ankesat për kthimin e banorëve vendor dhe jo vendor në këtë lokalitet dhe pengesat që po paraqiten për të kthyerit. Gjatë takimit me Avokatin e Popullit, Kryetari i Komunës së Obiliqit, kishte pohuar se prioritet për kthim kanë banorët e kësaj komune dhe kishte marrë edhe një kërkesë nga pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të kësaj komune se nëse ka rast të kthimit nga shtetet e rajonit të qytetarëve të këtyre komuniteteve, të cilët i kanë takuar më parë komunave të tjera, do ta kundërshtojnë kthimin e tyre edhe përmes protestave.
12. Avokati i Popullit theksoi se ka pranuar ankesat e familjeve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian lidhur me pengesat e tyre në kthimin në këtë lokalitet. Pengesat e vështirësitë mund të jenë të natyrave të ndryshme, teknike, administrative apo dhe të natyrave tjera, por është me interes që të kemi opinionet dhe qëndrimet edhe të komunitetit banorëve të këtij fshati për të marrë informacionet e nevojshme për çështjen e të kthyerve.
13. Përfaqësuesi i fshatit Plemetin theksoi se ky takim ka qenë më së i nevojshëm për t'u njoftuar me problemet e banorëve të fshatit. Më tej, ai deklaroi se në fshat kanë harmoni dhe bashkëpunim me banorët që kanë jetuar këtu para vitit 1990, por problemet kanë filluar të shfaqen me banorët e kthyer pas vitit 1999 të cilët nuk kanë qenë banorë të fshatit. Me ardhjen e banorëve të rinj, është rrezikuar siguria, ka pasur shumë incidente dhe raste mes familjeve, janë shtuar rastet e vjedhjeve, fëmijët e tyre nuk janë të sigurt të dalin në rrugë vetëm.
14. Në anën tjetër, autoritetet kompetente nuk kanë marrë masa shtesë për ta përmirësuar gjendjen në fshat, në këtë mënyrë ata kanë thënë se nuk kanë përfutur asgjë, përveç se, sipas tyre, u është vështirësuar jeta, duke u bërë e padurueshme jetesa për ta. Avokati i Popullit theksoi se e drejta për kthim dhe e drejta për të zgjedhur vendbanimin janë të drejta të garantuar me nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.



15. Më tej, Avokati i Popullit theksoi se te gjithë banoret duhet të kenë tolerancën e bashkëjetesës me njeri tjetrin dhe mirëkuptimin. Organet qeveritare qendrore që financojnë kthimet e banorëve, këto shqetësime të paraqitura nga banorët duhet t'i marrin parasysh seriozisht në politikat e kthimit ashtu që të ketë siguri dhe kushte për një mirëqenie për banorët që jetojnë aty.

## **BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE**

16. Kushtetuta, në nenin 21, paragrafi 3, përcakton: “Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”

17. Kushtetuta, në nenin 24, paragrafi 1, përcakton: “Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”; paragrafi 2 përcakton: “Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhje kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”

18. Kushtetuta, në nenin 53, përcakton: “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.” Ndërsa neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton: “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.” Tutje, neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

19. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut siguron se të gjithë njerëzit kanë të drejtë në standard të jetesës që është i përshtatshëm për shëndetin dhe për mirëqenën e tyre.

20. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 1, paragrafi 1, përcakton: “Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.”

21. Ndërsa në nenin 2, paragrafi 1.1, përcaktohet: “Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me[...]:

*1.5. mbrojtja sociale, përfshirë skemën e ndihmës sociale, sigurimin social dhe mbrojtjen shëndetësore;*



- 1.6. përparësitë sociale;
- 1.7. lehtësitë sociale, përfshirë, por pa u kufizuar në ndihmën humanitare;
- 1.9. qasje në vendbanim, i cili është në dispozicion për publikun, si dhe qasje në forma tjera të pronës (luajtshme dhe paluajtshme;
- 1.11. trajtimi i drejtë dhe i barabartë para organeve gjyqësore dhe të gjitha organeve të tjera që administrojnë drejtësinë; dhe
- 1.16. çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi”.
21. Neni 3, paragrafi 1, i Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përcakton konceptin e diskriminimit: “Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilësdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.” Ndërsa paragrafi 2 përcakton: “Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvlehtësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.”
22. Ligjin nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit në Republikën e Kosovës, neni 19 [Burimet e financimit të programeve të banimit] paragrafi 1, përcakton: “Programet e banimit mund të financohen nga:
- 1.1. buxheti i Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- 1.2. të hyrat e Komunës të dedikuara për banim;
- 1.3. kontributet e donatorëve të ndryshëm.”
23. Ligjin nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit në Republikën e Kosovës, neni 25, paragrafi 1 [Përgjegjësitë e komunave], nen paragrafi 1, përcakton se për zbatim të këtij ligji, Komuna bën: “Identifikimin e nevojave për banim, sipas programeve të hartuara për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre në bazë të këtij ligji.”; nën paragrafi 2: “Hartimin e programeve dhe projekteve tre (3) vjeçare për banim, bazuar në burimet financiare.”; dhe nën paragrafi 3: “Sigurimin e zonave për ndërtim dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatimin e programeve të banimit.”
24. Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 17, përcakton: “Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar: [...]
- i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- l) banimin publik.”
25. Rregullorja nr.01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, neni 5, paragrafi 1, përcakton: “Personat e zhvendosur brenda Kosovës



dhe te kthyerit spontan dorëzojnë aplikacionet e tyre për asistencë drejtpërdrejt në ZKKK në komunën e origjinës, në vendin e zhvendosjes apo ne komune tjetër ku dëshiron te kthehet.”; dhe neni 6, paragrafi 1.1, përcakton: “Aplikacioni i futur në bazën e të dhënave fillimisht trajtohet ne ZKKK të komunës ku personi i zhvendosur ka shpreh dëshirën të kthehet.”

## ANALIZA LIGJORE

26. Kushtetuta, si akti më i lartë juridik mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Prandaj zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Garantitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta, në nenin 21, paragrafi 3, shprehimisht përcakton obligimin e të gjithëve në respektimin e lirive dhe të të drejtave të të tjerëve.
27. Neni 24, paragrafi 1, i Kushtetutës përcakton se të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim; paragrafi 2 përcakton: “Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.” Prandaj, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se këto parime janë domosdoshmëri e kohës dhe duhet të respektohen nga të gjithë personat dhe nga institucionet, përfshirë këtu Komunën e Obiliqit, si dhe të gjitha institucionet tjera shtetërore relevante për çështjen e tanishme.
28. Sa i përket dhënies së përparësisë në kthim në rastin e tanishëm, Avokati i Popullit vëren se kjo përparësi do të ishte në kundërshtim me nenin 35 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila garanton se shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.
29. Neni 1 i Protokollit 12 [Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit], në paragrafin 1, parashikon: “Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”. Ndërsa, në paragrafin 2, parashikon se: “Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsytet e parashikuara në paragrafin 1.”
30. Fushëveprimi i nenit 1 të Protokollit 12 të KEDNj-së është qartësuar në rastin *Sejdić dhe Finci k. Bosnjës dhe Hercegovinës*:
- “Gjykata vëren se ndërsa neni 14 i Konventës ndalon diskriminimin në gëzimin e “të drejtave dhe lirive të përcaktuara në [Konventë]”, neni 1 i Protokollit nr. 12 e zgjeron fushën e mbrojtjes në **“çdo të drejtë të përcaktuar me ligj”**. Në këtë mënyrë prezanton një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit.
- Kërkuesit kundërshtuan dispozitat kushtetuese që i bënë ata të papërshtatshëm për t'u zgjedhur në Presidencën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Prandaj, nëse zgjedhjet për Presidencën bien apo jo brenda fushëveprimit të nenit 3 të Protokollit nr. 1, kjo ankesë ka të bëjë me një “të drejtë të përcaktuar me ligj” (shih seksionet 1.4 dhe 4.19 të Aktit



Zgjedhor 2001 - shih paragrafin 18 më lart) që e bën të zbatueshëm Nenin 1 të Protokollit Nr. 12.....”

31. Madje, sipas Raportit Shpjegues të Protokollit nr. 12, fushëveprimi i mbrojtjes së atij neni ka të bëjë me katër kategori rastesh, në veçanti kur një person diskriminohet:
- Në gëzimin e çdo të drejte që i jepet në mënyrë specifike një individ sipas ligjit kombëtar;
  - në gëzimin e një të drejte që mund të nxirret nga një detyrim i qartë i një autoriteti publik sipas ligjit kombëtar, domethënë, kur një autoritet publik është i detyruar sipas ligjit kombëtar të sillet në një mënyrë të caktuar;
  - nga një autoritet publik në ushtrimin e pushtetit diskrecional (për shembull, dhënien e subvencioneve ose ndihmave);
  - nga çdo veprim ose mosveprim tjetër nga një autoritet publik (për shembull, sjellja e oficerëve të zbatimit të ligjit kur kontrollojnë një revoltë). (§ 22 i Raportit shpjegues).
32. Kategoritë e sipërpërmendura zbatohen edhe në rastin *Savez Crkava "Riječ Života" & al. k. Kroacisë*, (paragrafi 104 dhe 105)
33. Rrjedhimisht, nisur nga interpretimi i nenit 1 të Protokollit 12, i cili shtrin fushën e mbrojtjes për **“çdo të drejtë të parashikuar nga ligji”** dhe vendos një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit, që nënkupton situata kur çështja bie në fushën e veprimit të një të drejte substanciale të garantuar nga ligji i brendshëm, pra e drejta për të zgjedhur vendbanimin dhe të drejtat tjera që burojnë nga zgjedhja e vendbanimit bie në fushën e një të drejte të rregulluar me ligj. E drejta për ta zgjedhur vendbanimin në vendin tonë është i rregulluar me Kushtetutë si dhe me akte përkatëse ligjore.
34. Po ashtu, Parimet Udhëzuese të OKB-së për të Zhvendosurit Brenda Vendit, ndër të tjera parashohin se personat e zhvendosur brenda vendit duhet të gëzojnë në mënyrë plotësisht të barabartë të njëjtat të drejta dhe liri të cilat, sipas të drejtës ndërkombëtare dhe vendore, i gëzojnë të gjithë personat tjerë, në vendin e tyre. Ata nuk do të diskriminohen në gëzimin të gjitha të drejtave dhe lirive, bazuar në faktin se janë persona të zhvendosur.<sup>2</sup> Më tej, këto parime, përcaktojnë se çdo person i zhvendosur gëzon të drejtën e lirisë së lëvizjes dhe lirinë për të përzgjedhur *vendbanimin*. Prandaj, dallimi në trajtim në rastin e tanishëm nuk ka justifikim.
35. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ka si qëllim përcaktimin e një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, [...] ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë dhe ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizikë dhe juridikë, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund t'i shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizikë dhe juridikë, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me [...]: mbrojtjen sociale, përparësitë sociale; lehtësitë sociale, qasje në vendbanim, i cili është në dispozicion për publikun, si dhe qasje në forma të tjera të pronës (së luajtshme

<sup>2</sup> United Nations, Guiding Principles on Internal Displacement, September 2004, Parimet 1 dhe 14. I qasshëm në: <https://www.unhcr.org/43ce1cff2.pdf>



dhe të paluajtshme); trajtimi i drejtë dhe i barabartë në organet gjyqësore dhe në të gjitha organet e tjera që administrojnë drejtësinë; çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi.

36. Avokati i Popullit, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi në Kosovë, vlerëson se dhënia e çfarëdo përparësie të qytetarëve që janë të komunës së Obiliqit, sikurse në rastin konkret, në ofrimin e shërbimeve në raport me refuzimin e të njëjtave shërbime për personat e kthyer, me arsyetimin se nuk i përkasin kësaj komune, përbën diskriminim dhe favorizim për banorët e tanishëm të komunës së Obiliqit në bazë të lokalitetit ku jetojnë, meqë sipas Kushtetutës dhe ligjeve të tjera në Kosovë, të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet. Diskriminim është çdo *dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë* në çfarëdo baze të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, që ka për qëllim apo për efekt të zhvleftësojë ose të cenojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe të lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet e tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
37. Ligjin nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit në Republikën e Kosovës, në kuadër të përgjegjësisë të komunave, përcakton se komuna bën identifikimin e nevojave për banim, sipas programeve të hartuara për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre në bazë të këtij ligji, hartimin e programeve dhe projekteve trevjeçare për banim, bazuar në burimet financiare dhe sigurimin e zonave për ndërtim dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatimin e programeve të banimit. Bazuar në këtë ligj, sigurimi i banimit është përgjegjësi e vetë komunave.
38. Në bazë të këtij ligji, sigurimi i banimit bëhet përmes programeve të veçanta të banimit, kurse programet e veçanta të banimit financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), të hyrat e komunave të dedikuara për banim dhe kontributi nga donatorët. Bazuar në informatat e Avokatit të Popullit, Komuna e Obiliqit nuk ka vepruar në pajtim me këto dispozita ligjore. Për më tepër, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, përmes shkresës zyrtare Nr.463-1442 të MAPL, të datës 21 tetor 2016, i kishte njoftuar komunitat, duke ua sqaruar atyre procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale.
39. Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale përcakton se komunitat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, mes tjerash, duke i respektuar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesja për të cënueshmit, strehimin familjar dhe banimin publik. Prandaj, përderisa këto kompetenca ligjore janë të obligueshme sipas këtij ligji, Komuna e Obiliqit duhet t'i ketë parasysh zbatimin e tyre në praktikë, duke mos bërë asnjë lloj dallimi mes personave, pavarësisht se a i takojnë kësaj komune apo janë persona të kthyer në këtë komunë.
40. Rregullorja nr.01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme përcakton se personat e zhvendosur brenda Kosovës dhe të kthyerit spontanë dorëzojnë aplikacionet e tyre për asistencë drejtpërdrejt në ZKKK në komunën e origjinës, në vendin e zhvendosjes apo në komunë tjetër ku dëshirojnë të kthehen dhe aplikacioni i futur në bazën e të dhënave fillimisht trajtohet në ZKKK të komunës ku personi i zhvendosur ka shprehur dëshirën të kthehet.



41. Bazuar në këtë dispozitë të kësaj rregulloreje, nënkuptohet se personat e kthyer mund të zgjedhin vendin ku ata dëshirojnë të kthehen nga vetë fakti që dokumentacionet, përkatësisht aplikacionet e tyre për asistencë mund t'i dorëzojnë drejtpërdrejt në ZKKK në komunën ku ata dëshirojnë të kthehen dhe është plotësisht vullnet i tyre zgjedhja e vendit të kthimit të tyre. Përgjigjja e Komunës së Obiliqit, përkitazi me rastin, e dërguar në IAP më 25 qershor 2019, nuk ishte në frymën e kësaj rregulloreje.

## KONSTATIMET

42. Avokati i Popullit, konstaton se mohimi i të drejtës për të zgjedhur vendbanimin paraqet shkelje të të drejtave të njeriut, e përcaktuar me nenin 35 të Kushtetutës, legjislacionin përkatës vendor, si dhe Parimet Udhëzuese të OKB-së për të Zhvendosurit Brenda Vendit. Po ashtu, Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi në Kosovë, dhënia e çfarëdo përparësie ndaj qytetarëve që janë të komunës së Obiliqit, si në rastin konkret, në ofrimin e shërbimeve në raport me refuzimin e të njëjtave shërbime për personat e kthyer, me arsyetimin se nuk i përkasin kësaj komune, përbën diskriminim dhe favorizim për banorët e tanishëm të komunës së Obiliqit. Një praktikë e tillë e Komunës është në kundërshtim me konceptin e nocionit të mos diskriminimit.
43. Avokati i Popullit vlerëson se e drejta për banim është njëra nga çështjet mjaft të rëndësishme për stabilitetin social, shëndetin dhe zhvillimin kualitativ të mirëqenies njerëzore. Në shumicën e vendeve të zhvilluara, banimi është e drejtë sociale e qytetarëve. E drejta e banimit ka efekte të gjera, si: sociale, kulturore, ekonomike etj. Andaj projektet e banimit social janë mjaft të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve të pastrehë.
44. Sipas Ligjit nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit në Republikën e Kosovës, në kuadër të përgjegjësisë të komunave, përcaktohet se komuna bën identifikimin e nevojave për banim, sipas programeve të hartuara për popullsinë nën juridiksionin territorial të tyre në bazë të këtij ligji, hartimin e programeve dhe projekteve trevjeçare për banim, bazuar në burimet financiare dhe sigurimin e zonave për ndërtim dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, në zbatimin e programeve të banimit.
45. Avokati i Popullit konstaton se komunat bazuar në Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ato duhen të ofrojnë shërbimet familjare dhe të shërbimet tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesja për të cënueshmit, strehimin familjar dhe banimin publik, dallimi mes personave, pavarësisht se a i takojnë kësaj komune apo janë persona të kthyer në këtë komunë, sepse ky ligj përcakton se komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal.
46. Avokati i Popullit konstaton se komunat bazuar në Rregulloren nr.01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, duhet të mundësojnë personave të kthyer që të zgjedhin vendin ku ata dëshirojnë të kthehen nga vetë fakti që dokumentacionet, përkatësisht aplikacionet e tyre për asistencë mund t'i dorëzojnë drejtpërdrejt në ZKKK në komunën ku ata dëshirojnë të kthehen dhe është plotësisht vullnet i tyre zgjedhja e vendit të kthimit të tyre, siç është sqaruar edhe nga MAPL-ja përmes shkresës zyrtare Nr.463-1442 të MAPL-së, të datës 21 tetor 2016, ku sqarohen procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, në të tilla raste, sikurse rasti i personave të kthyer në Plemetin.



47. Duke u bazuar në situatën komplekse të kthimit të tanishëm dhe shqetësimet e banorëve të Plemetit, Avokati i Popullit konstaton se, çështja duhet të zgjidhet përmes bashkëpunimit të të gjitha organeve qeveritare përkatëse, përfshirë këtu Ministrinë për Kthim dhe Komunitete, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe të gjitha organeve tjera, në mënyrë që e njëjta të mos mbetet barrë vetëm për Komunën e Obiliqit, e cila mund të jetë e papërbalueshme për këtë komunë.
48. Avokati i Popullit, duke u bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*” Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: “*(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla (...).*”; si dhe: “*Të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.*” (Neni 18, paragrafi 1.7). Prandaj Avokati i Popullit i

## REKOMANDON

Ministrinë për Komunitete dhe Kthim që:

- *Në bashkëpunim me komunat në Republikën e Kosovës, të krijojë kushte për kthim të qëndrueshëm, mbrojtje, integrim dhe zhvillim të komuniteteve bazuar në misionin dhe vizionin për të cilin është themeluar si institucion shtetëror.*

Komunës së Obiliqit që :

- *Të ndërmarr veprime për krijimin e kushteve të përshtatshme për banim për familjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të kthyer në fshatin Plemetin, në përputhje me Ligjin nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit në Republikën e Kosovës apo përmes formave të tjera të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi.*
- *Të ketë parasysh zbatimin e Rregullores nr.01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, konkretisht nenin 15, par.5, që të kthyerit që konsiderohen në kategorinë e rëndë përfitojnë nga alokimi i tokës komunale me të drejta të shfrytëzimit për një afat të caktuar sipas Ligjit përkatës për Dhënie të Shfrytëzimit dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nga asistenca e plotë e ndërtimit në përputhje me këtë rregullore.*
- *Kthimi i të zhvendosurve të bëhet në pajtim me Rregulloren nr.01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, pavarësisht vendbanimit të mëparshëm dhe të tanishëm.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj*”) dhe nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të*



*përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.*

Me nderime,

Naim Qelaj

Ayokat i Popullit

